

VENDIM
Nr.220, datë 12.3.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË TATIMPAGUESVE DHE TË
KRITEREVE TË PËRDORIMIT TË PROCEDURËS SË THJESHTËZUAR TË
FISKALIZIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 1, dhe 27, pika 1, të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tatimpaguesit që lëshojnë fatura për transaksione me para në dorë, sipas nenit 22, të ligjit nr.87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, mund të lëshojnë fatura dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit përmes përdorimit të platformës qendrore të faturave, nëse përmbushin **njëkohësisht** kriteret e mëposhtme:

- a) Nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar;
- b) Kanë përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;**
- c) Nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.
- d) Kanë statusin ligjor “Person fizik” dhe kategorinë e punësimit “I vetëpunësuar i vetëm.”**

(Shtuar dhe ndryshuar me VKM Nr. 1091, datë 24.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 233, datë 30.12.2020)

2. Tatimpaguesit që nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, të cilët lëshojnë fatura elektronike për transaksione pa para në dorë, sipas nenit 27, të ligjit nr.87/2019, mund të lëshojnë fatura elektronike dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit përmes përdorimit të platformës qendrore të faturave, nëse përmbushin **njëkohësisht** kriteret e mëposhtme:

- a) Kanë përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;**
- b) Nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.
- c) Kanë statusin ligjor “Person fizik” dhe kategorinë e punësimit “I vetëpunësuar i vetëm.”**

2.1. Tatimpaguesit që kryejnë transaksione pa para në dorë me organet publike mund të lëshojnë dhe fiskalizojnë fatura elektronike për këto transaksione nëpërmjet platformës qendrore të faturave, deri në datën 30 qershor 2021.

2.2. Organet publike qendrore dhe vendore mund të lëshojnë fatura dhe fatura elektronike dhe të kryejnë procedurën e fiskalizimit për transaksionet që kryejnë, përmes përdorimit të platformës qendrore të faturave.”

(Shtuar dhe ndryshuar me VKM Nr. 1091, datë 24.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 233, datë 30.12.2020)

3. Tatimpaguesi që lëshon fatura sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, mund të përdorë platformën qendrore të faturave për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, për sa kohë që përmbush të gjitha kriteret e kërkuara. Në momentin kur një nga kriteret nuk përmbushet më prej tatimpaguesit, tatimpaguesi nuk mund të përdorë më tej platformën qendrore të faturave për lëshimin dhe fiskalizimin e faturave, por duhet të zbatojë procedurën e fiskalizimit me anë të zgjidhjeve software-ike të certifikuara, sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara në ligjin nr.87/2019.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet respektivisht në të njëjtën kohë me afatet e përcaktuara në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.42, date 19.03.2020.

Ndryshuar:

- VKM Nr. 1091, datë 24.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 233, datë 30.12.2020